



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.530/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, Sefedin Sadriu nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat: ZL.A.nr.530/2017, ZL.A.nr.531/2017, dhe ZL.Anr.532/2017, të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, Sefedin Sadriu nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 26.10.2017, PZAP-i ka pranuar 3 (tri) ankesa nga Sefedin Sadriu, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Shtimes, nga radhët e subjektit politik LDK, me të cilat pretendon se në qendrat e votimit : VV - 2201X/01R, VV - 2201E/02R, dhe në VV - 2212E,01D, kanë votuar familjarët e tij, mirëpo votat e tyre mungojnë. Po ashtu parashtuesi i ankesës ka theksuar se nga informatat që ka marur nga vëzhguesit e këtyre vendvotimeve, mungesa e votave ka ardhur si pasojë e një gabimi teknik që është bërë.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.530/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të tri ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtuara përkitazi me mungesën e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat

e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit Sefedin Sadriu, nuk e paragjykon çështjen dhe atij nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.530/2017 me datën 31.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa .*